



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1491/2 Prot.

Tiranë, më 06.11.2025

V E N D I M

Nr. 250, Datë 06.11.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 245, datë 24.10.2025, e paraqitur nga znj. S.S kundër znj. K.P (banues në të njëjtin pallat me ankuesen), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “orientimit seksual”, “moshës” dhe “gjendjes martesore”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesja në mes të tjerash informon se: *“Jam me profesion Avokate dhe Ndërmjetëse dhe paraqes këtë kërkesë tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me diskriminimin, përndjekjen dhe keqpërdorimin e institucioneve shtetërore që po ushtrohen ndaj meje nga znj. K.P dhe bashkëpunëtorët e saj. Përshkrimi i fakteve dhe rrethanave:*

Fakti 1 - Fyerje dhe shpifje për orientimin seksual (01.04.2022).

Në këtë datë, G dhe znj. K.P (bashkëshortë) nisën një fushatë shpifjeje dhe fyerjeje duke shpërndarë informacion të pavërtetë dhe të dëmshëm lidhur me orientimin tim seksual. Këto akuza të pabazuara u përdorën për të dëmtuar reputacionin tim personal dhe profesional. Lidhja shpirtërore në trajtimin ligjor të veprave penale të përndjekjes (stalking). Ky koncept përfshin marrëdhënie të ngushta emocionale dhe personale që tejkalojnë njohjet e thjeshta apo marrëdhëniet sociale të rastësishme, duke përfshirë: marrëdhënie familjare, bashkëshortët dhe bashkëjetuesit aktualë dhe të mëparshëm, prindërit dhe fëmijët, vëllezërit dhe motrat, anëtarë të tjerë të ngushtë të familjes, marrëdhënie sentimentale apo intime.

Fakti 2 - Intensifikimi i shpifjeve dhe fyerjeve në ambient profesional (01.06.2022).

Veprimet ofenduese u intensifikuan duke u përhapur edhe në ambientet profesionale, me qëllim të minimimit të besimit të klientëve dhe bashkëpunëtorëve ndaj meje, duke krijuar një klimë diskriminimi dhe pengesa në zhvillimin tim profesional.

Fakti 3 - Shpifjet para promovimit të Qendrës së Ndërmjetësimit në Elbasan (14.05.2022).

Në ditët para hapjes së Qendrës së Ndërmjetësimit, ku unë isha ngarkuar për monitorimin e procesit në Elbasan, shpifjet u shtuan me qëllim diskreditimin e imazhit tim dhe pengimin e angazhimeve profesionale.

Fakti 4 — Manipulimi i dëshmive dhe provave të rreme.

Të kallëzuarit kanë përdorur persona të tjerë, përfshirë komshiun tim, për të manipuluar dëshmi që do të përdoren në procedurat penale, me qëllim dëmtimin e imazhit dhe karrierës time.

Fakti 5 - Veprime të koordinuara me prokurorinë dhe abuzim me fondet publike.

Veprimet e ndjekjes penale ndaj meje janë sajuar nga persona të caktuar në polici dhe janë koordinuar me prokurorë të caktuar, me qëllimin e favorizimit të znj. K.P. Këto veprime janë realizuar duke abuzuar me fondet e buxhetit të shtetit, për një vepër penale që nuk përmbush kriteret ligjore. Çështja në fjalë ka të bëjë me mosmarrëveshjet për larjen e shkallëve dhe lënien e biçikletave në sheshpushimin e pallatit, të cilat nuk përbëjnë shkak për ndjekje penale. Prokuroria e Elbasanit ka vepruar në mënyrë të njëanshme, duke favorizuar palët dhe duke penguar drejtësinë.

Fakti 6 - Transferimi në Tiranë dhe vazhdimi i përndjekjes.

Edhe pse u transferova në Tiranë për shkak të angazhimeve profesionale, përndjekja dhe kërcënimet ndaj meje dhe nënës sime vazhduan në formë të vazhdueshme dhe të koordinuar nga shtetasit e përmendur.

Fakti 7 - Mundësia për pajtim e sajuar dhe mashtrimi nga personat përgjegjës.

Znj. K.P i është dhënë mundësia për pajtim, e cila u ndërmjetësua nga shtetasi A.S. Por ky proces ishte një pretekst për manipulim dhe mashtrim, i dokumentuar edhe nga akti i ekspertimit psikologjik në dosjen nr. 502/2022, që evidenton problemet serioze me personalitetin e znj. K.P dhe bashkëpunimin e saj me personat përgjegjës për përndjekjen time.

Fakti 8 - Shpifje dhe kallëzim i rremë ndaj meje dhe nënës sime.

Znj. K.P ka paraqitur kallëzime të rreme në bashkëpunim me individë të tjerë, duke përdorur këto akuza si mjet për të ushtruar presion dhe përndjekje të vazhdueshme ndaj mejë për shkak të orientimit seksual.

Fakti 9 – Cenim i jetës private dhe dinjitetit përmes shpifjeve për orientimin tim seksual dhe akuzave për armëmbajtje.

Janë përhapur informacione të pavërteta dhe të dëmshme lidhur me orientimin tim seksual, si dhe akuza të sajura për posedim dhe përdorim të paligjshëm të armëve në ambient publik, të cilat kanë shkaktuar dëme serioze në jetën time private dhe në sigurinë personale.

Fakti 10 - Zvarritje abuzive e procedurës hetimore.

Prokuroria ka zvarritur hetimet për gati tre vjet, pa regjistruar personin e kallëzuar dhe pa dhënë një vendim përfundimtar, duke shkelur të drejtën time për një proces të drejtë dhe të shpejtë. Kjo ka konsumuar veprën penale të Shpërdorimit të Detyrës nga ana e personave të përmendur, duke përfshirë znj. K.P, z. G.P dhe vajzat e tyre, të cilat janë përdorur edhe për të sulmuar orientimin tim seksual.

Fakti 11 - Shpërndarja pa leje e imazheve personale në institucione profesionale.

Imazhet e mia personale janë shpërndarë pa pëlqimin tim në Dhomën Kombëtare dhe Vendore të Avokatisë, duke cenuar privatësinë dhe dinjitetin tim profesional”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që të caktohet dëmshpërblimi moral dhe ekonomik në favorin e saj për dëmtimet e vazhdueshme të shkaktuara në periudhën nga viti 2022 e në vazhdim nga personat përgjegjës dhe të merren masa disiplinore ndaj personave përgjegjës brenda institucioneve.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqet e “orientimit seksual, moshës gjendjes martesore” duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesja pranë KMD-së, konstatohet se:

Së pari, bazuar në nenin 33/3, të LMD-së përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44/2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, gërma b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:...b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjerash personash, përbën diskriminim”.

Për të vlerësuar legjitimitetin e palës kundër të cilit drejtohet ankesa, Komisioneri do i referohet parashikimeve të bëra në nenet 24, 25 dhe 26 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Kështu, në këtë kod përcaktohet përmbajtja e personit juridik: “24. **Personat juridikë janë publikë dhe privatë.** 25. **Personat juridikë publikë janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik. Institucionet dhe entet shtetërore, që nuk ndjekin qëllime ekonomike, nuk regjistrohen.** 26. **Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji**”.

Referuar parashikimeve të mësipërme, vlerësohet se “sektori publik” mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të administratës, ndërmarrjeve publike dhe organizmave publikë të sigurimeve shoqërore, ndërsa “sektori privat” mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të personave juridikë privatë, sipas përcaktimeve të nenit 26, të Kodit Civil.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përmbushje të qëllimit të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, shqyrton ankesat që drejtohen kundër autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë.

Bazuar në informacionin e administruar, rezulton se, shtetasit znj. K.P dhe z. G.P, janë dy persona privatë (bashkëshortë), që banojnë në një pallat me ankuesen, që nuk ushtrojnë funksione publike dhe nuk ofrojnë shërbime publike/private kundrejt saj, pra janë persona që nuk marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë. Në këtë kuptim, konflikti mes ankueses dhe shtetasve znj. K.P dhe z. G.P, lidhet me mosmarrëveshje në kuadër të bashkëjetesës në komunitet, në pallat dhe jo me faktin nëse ata ofrojnë shërbime publike/private kundrejt saj.

Për sa më sipër, bazuar në dispozitat e cituara më lart dhe parashikimeve të bëra në ligjin 10221/2021 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, rezulton se, znj. K.P dhe z. G.P, nuk legjitimohen si subjekte kundër të cilëve mund të paraqitet ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹.

Bazuar në nenin 33/4, germa “b”, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ... b), ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”*.

Së dyti, lidhur me pretendimet e ankueses për veprimet e Prokurorisë Elbasan.

Ligji nr. 115/2016 *“Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”*, i ndryshuar, në nenin 194, përcakton se: *“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë; ...”*.

Përsa më sipër, legjislacioni parashikon se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve. Në rastin konkret, sa i përket veprimeve të cituara në ankesë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjykon se nuk ka kompetencë për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore të kryera nga ana e prokurorëve, apo vendimmarrjes së tyre sa i përket procedimeve penale, pasi ky autoritet i atribuohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33/4, germa “b”, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Së treti, lidhur me pretendimin e ankueses për shpërndarjen e imazheve personale pa leje.

Komisioneri vëren se, mbrojtja e të dhënave personale nga subjekti i sipërpërmendur, ka të bëjë me moszbatimin dhe shkeljen e dispozitave ligjore të ligjit nr. 124/2024 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, dhe kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të

¹ Për analogji citojmë: Vendimi nr. 120, datë 30.06.2021, nr. 80, datë 09.06.2023 dhe nr. 203, datë 19.10.2023.

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Lidhur me pretendimin e ankueses së znj. K.P ka shpërndarë imazhet e saj personale pa leje, Komisioneri vlerëson se, autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit nr. 124/2024 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDMDHP).

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e pretendimit të shtetasës Znj. S.S, për shpërndarjen e imazheve të saja personale nga ana e znj. K.P, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Për sa më sipër, subjekti ankues mund t'i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me pretendimin për mbrojtjen e të dhënave personale.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a, nenin 33, pika 4, gërma “b” të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 245, datë 24.10.2025, të paraqitur nga znj. S.S kundër znj. K.P, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA